



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI I LËNDËS
Teknika të guidimit B

Ngarkesa: 4 ECTS, 20 leksione + 20 seminare

Viti , Semestri: Viti II , semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i shkencave në “Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik Trigjuhësh”

Kodi i etikës: Kodi i etikës të UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT :

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me njohuri të thelluara mbi proceset dhe aktorët kryesorë në guidimin turistik dhe marrëdhëniet ndërvepruese me ta. Të zhvillojë aftësitë për ndërtimin dhe standardizimin profesional të një produkti turistik dhe për përgatitjen e materialeve të udhërrëfimit. Të njohë kuadrin ligjor dhe të kuptojë ndarjen e roleve midis udhërrëfyesit dhe tourliderit në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të analizojë ndikimin e faktorëve politikë, ekonomikë, socialë e kulturorë në procesin e guidimit dhe t'i kthejë këto në vlera për turistin.
2. Të përvetësojë teknikat dhe mjetet për ndërtimin e një udhërrëfyesi profesional dhe të vendosë kritere cilësie për vlerësimin e tij.
3. Të ndërtojë në mënyrë të pavarur një produkt turistik të standardizuar dhe tërheqës për tregun.
4. Të njohë detyrat, përgjegjësitë dhe kufijtë midis rolit të udhërrëfyesit dhe atij të tourliderit, si dhe kontekstin ligjor përkatës.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti është në gjendje të ndërtojë dhe të aplikojë një udhërrëfyes të strukturuar profesionalisht, duke integruar njohuri kulturore dhe praktike në shërbim të turistit.
2. Studenti demonstroi aftësi për të krijuar një produkt turistik të standardizuar, duke respektuar parimet e cilësisë dhe atraktivitetit bashkëkohor.
3. Studenti dallon qartë rolet dhe përgjegjësitë e udhërrëfyesit dhe tourliderit, si dhe i referohet kuadrin ligjor në mënyrë të informuar dhe të përditësuar.